



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:158367

Datë: 04.03.2024

Numri i dokumentit: 05406502

PKR.nr.33/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për Krime të Rënda, me Kryetarin e Trupit Gjykues, Shaqë Curri dhe anëtarët e trupit gjykues Sami Sharaxhiu dhe Violeta Husaj Rugova, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale ndaj të pandehurit Rr.Xh., për shkak të veprës penale, Vrasje e Rëndë e mbetur në tentativë nga neni 147 par. 1 nën par. 1.11 lidhur me nenin 20 i KPPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë së Qarkut në Mitrovicë, PP. nr. 67/08 të dt. 29.07.2008, mbajti seancat publike të shqyrtimit gjyqësor me datë, 29.09.2023, 27.11.2023, 25.01.2024 dhe 12.02.2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Ersan Qavolli, të pandehurit Rr.Xh., mbrojtësit të tij av. M. H., sipas autorizimit dhe mbrojtësit të viktimave Luan Mehmetaj, me datë 15.02.2024, bie dhe shpall publikisht, ndërsa me, dt.04.03.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri

Rr.Xh., i biri idhe nënës, e vajzërisë, i lindur me dt., në fshatin, Komuna e, ku edhe jeton, ka të kryer katër klasë të shkollës fillore, i martuar, baba i pesë fëmijëve, pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. se Kosovës, ka qëndruar ne paraburgim nga dt.28.05.2008 e deri me dt.21.07.2008, tani gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datën 28.05.2008, rreth orës 10:55min në M. rr. “...”, afër urës kryesore mbi lumin I., përballë palestrës sportive “...”, me dashje tenton t’i kryej dy vrasje dhe atë tenton të privojë nga jeta viktimat K.Z. dhe V. Z., në atë mënyrë që, pas një mosmarrëveshje rreth aksidentit të komunikacionit të shkaktuar me datën 26.05.2008, mes të akuzuarit Rr. dhe të dëmtuarit K., i akuzuari me datën 28.05.2008, fillimisht shkon në një lokal afër gjimnazit, pastaj shkon tek kafja e gjahtarëve, më pas nis për në drejtim të komunës, pastaj kthehet kah ndërtesat e reja

rrokaqielli, pastaj afrohet në anën e kundërt të palestrës sportive dhe rreth orës 10:55min, pasi i sheh të dëmtuarit në vendin e lartcekur kalon në trotuar tek palestra ku ishin të dëmtuarit dhe me një thikë patentë, fillimisht e godet 5 herë viktimën K. Z. në regjionin e kraharorit afër zemrës, bark, shpinë dhe dorën e majtë, për çka i shkakton *plagë në pjesën e abdomenit dhe të toraksit me mjet prerës shpues*, e më pas për t'i ndarë ndërhyv viktimë V. Z. por i akuzuari me të njëjtën thikë e godet edhe 9 herë viktimën V. i cili ka pësuar *9 plagë prerëse – shpuese në toraks, pjesën e komblikut dhe në parakrahun e majtë dhe si të tilla për pasojë ka ardh edhe deri te prezenca e ajrit në hapësirën e majtë torakale të shkaktuar nga mjete shpues – prerës.*

- Me çka ka kryer veprë penale vrasje e rëndë e mbetur në tentativë nga neni 147 par. 1 nën par. 1.11 lidhur me nenin 20 i KPPK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 6, 34, 36, 38, 60 par. 1, 64, 65, të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, 147 par. 1 nën par. 1.11 lidhur me nenin 20 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, nenit 364 të KPP-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

Dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, e të cilin dënim i pandehuri do të vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet të paguajë shpenzimet e procedurës penale, në shumë prej 200 (dyqind) euro, dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 100 (njëqind) euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që ta paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurit i konfiskohet thika e përdorur në rastë

Pala e dëmtuar K. Z. dhe V. Z., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë ka ngritur aktakuzë PP.nr. nr. 67/08 të datës 29.07.2008 kundër të pandehurit Rr.Xh., nga fshati Bare Komuna e Mitrovicës për shkak të veprës penale vrasje e rëndë e mbetur në tentativë nga neni 147 pika 11 e lidhur me nenin 20 të KPPK-së.

Me dt. 22.11.2019, Gjkata Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda shpalli aktgjykimin P.nr. 96/08 me të cilin të pandehurin Rr.Xh. për veprën penale vrasje e rëndë e

mbetur në tentativë nga neni 147 pika 11 e lidhur me nenin 20 të KPK-së është shpallur dhe është dënuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim dhe atë nga data 28.05.2008 deri me dt. 21.07.2008.

Gjykata e Apelit me dt. 17.12.2020, ka aprovuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit Rr. Xh. av. M. H. dhe ka marr aktvendimin PAKR.nr. 199/2020 me të cilin ka anuluar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës P.nr. 96/08 të dt. 22.11.2019 dhe çështjen e ka kthyer të njëjtës gjykatë për rigjykim.

Kjo lëndë së bashku me shkresa e lëndës për vazhdimin e procedurës penale nga Gjykata Themelore e Mitrovicës në Gjykatën Themelore në Pejë, është pranuar me dt. 25.02.2023.

Gjykata duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë së Qarkut në Mitrovicë, PP. nr. 67/08 të dt. 29.07.2008, dhe vërejtjeve të gjykatës së Apelit, mbajti seancat publike të shqyrtimit gjyqësor me datë, 29.09.2023, 27.11.2023, 25.01.2024 dhe 12.02.2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Ersan Qavolli, të pandehurit Rr.Xh., mbrojtësit të tij av. M. H., sipas autorizimit, mbrojtësi i viktimave Luan Mehmetaj, ndërsa kanë munguar të dëmtuarit K. Z.dhe V. Z. e të cilët kanë qenë të njoftuar në mënyrë të rregullt përmes ftesave të dërguar nga Gjykata përmes Ministrisë së Drejtësisë- Departamenti për Bashkëpunim Juridike Ndërkombëtarë, pasi që të dëmtuarit jetojnë në qytetin Osjek të Republikës së Kroacisë.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor të dt. 27.11.2023, ka dëgjuar dëshmitarin S. S., ndërsa me dt. 25.01.2024, është dëgjuar eksperti mjeko ligjor Dr.Naim Haliti, pastaj ka lexuar deklaratat të dëmtuarve dhe dëshmitarëve si dhe ka administruar provat materiale.

Meqenëse të dëmtuarit K. Z. dhe V. Z., kanë qenë të ftuar të marrin pjesë në seancën gjyqësore, në rigjykim të njëjtit nuk kanë qenë prezentë, andaj gjykata me qëllim që çështja mos të prolongohet procedura, ka aprovuar propozimin e Prokurorit të Shtetit, që deklaratat e tyre të dhëna në procedurën paraprake dhe në shqyrtimin gjyqësor të dt. 21.01.2019 të lexohen, ku me këtë rast është lexuar, deklarata e të dëmtuarit -dëshmitar K. Z. e dhënë në procedurën paraprake me dt. 28.05.2008 (në fillim të deklaratës është e shënuar dt. 28.05.2008, ndërsa kur fillon përpilimi i të njëjtës është shënuar dt. 12.06.2008), dhe deklarata e dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt. 21.01.2019, dhe Deklarata e të dëmtuarit-dëshmitar V. Z. e dhënë në procedurën paraprake me dt. 12.06.2008 dhe në shqyrtimin gjyqësor të dt. 21.01.2019 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.

Gjykata ka lexuar deklaratën e dëshmitarit S. B. e dhënë në procedurën paraprake me dt. 18.07.2008, pasi që nga shkresat e lëndës respektivisht Certifikata e Vdekjes me nr, reference 27/2018RV/27001, rezulton se i njëjti ka vdekur. Po ashtu gjatë shqyrtimit gjyqësorë është lexuar, deklarata e dëshmitarit R. B. e dhënë në procedurën paraprake me dt. 18.07.2008, pasi që sipas raportit policor dëshmitari R.B. që disa vite jeton në Suedisë, si dhe janë shikuar dhe administruar, raporti identifikues i forenzikës i dt. 28.05.2008, fletë-lëshimi me ekspertizë lëshuar QKUK në Prishtinë-Klinika Kirurgjisë-Kirurgjia abdominale “B” 3830/08, në emër të K. Z., fletë lëshimi lëshuar QKUK në Prishtinë-Klinika Kirurgjisë-Kirurgjia torokale me numër amëz 3831/2008, në emër të V. Z., certifikata mjekësore e lëshuar nga Qendra spitalore “Sheikh Zayed”-reparti i kirurgjisë në Vushtri në emër të K. e V. Z., të dt. 27.06.2008, nga dr. Isuf Zekaj-kirurg, foto dokumentacionet, raporti mjekësor për K. Z., me nr. 17539, i lëshuar nga QKUK-Prishtinë, raporti i aksidentit i dt. 26.05.2008, kundërvajtja me nr. 1403613, e të njëjtës datë,

dokumentet e veturave të përfshira në aksidentit, raporti i oficerit Shyqri Mjeku, si dhe shkresat tjera të lëndës.

Dëshmitari, S. S. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se qëndron pranë deklaratës së dhënë me dt. 03.04.2019 në gjykatën e Mitrovicë. Të pandehurin ka thënë se më parë nuk e ka njoft personalisht pas ngjarjes e ka kuptuar se kush është, ndërsa të dëmtuarit K. dhe V. Z. i ka kushëri jetojnë në Osijek të Kroacisë prej viti 1950. Ndërsa lidhur me rastin dëshmitari ka theksuar se ka kalu një kohë e gjatë dhe ngjarja i rrin në koke si një ëndërr e keqe, dhe ka përshkruar ditën kur atë ditë në cilësinë e ekspertit të komunikacionit është takuar me kushëririn e tij K. Z. i cili kishte qenë në st. Policor sepse kishte pasur një aksident dhe kishte shkuar për të marr procesin e aksidentit (për të cilin nuk e di se me kë ka pasur K. aksident) dhe më pas me dëshmitarin dhe me nipin e K. V. Z. janë takuar tek Ura e I. në M. saktësisht tek palestra e sporteve përafërsisht 200-300 metra larg st. Policor, ku kanë qëndruar 5 apo 10 min, brenda palestrës sporteve në M.. Kur kanë dal nga palestra e sporteve dëshmitari ka komunikuar me nipin e K. V. në gjuhën serbokroate dhe derisa kanë qenë duke bisedu i kanë sulmu disa veta, dëshmitari ka menduar që arsyeja ka qenë se pse po flasin në gjuhën serbokroate dhe i njëjti i ka bërëit “se jemi shqiptar jemi shqiptar”. Dëshmitari gjatë deklaramit të tij ka thënë se në këtë sulm nuk ka qenë i sulmuar, vetëm ka pasur një gërvishtje, i njëjti nuk ka mundur të dij se nga cila ane janë sulmuar dhe nuk ka pasur mundësi as t’i ndajë e as të ndërhyjë e as nuk ka mund ti identifikojë fytyrat as atëherë e as tani, nuk i janë kujtuar se kush ka sulmu i pari, nuk e dinë se a ka sulmuar K. me V. apo pala e kundërt sepse në atë moment ka qenë duke biseduar me V., si dhe nuk e din se me çka janë sulmuar të dëmtuarve iu ka parë vetëm plagë, këto plage i ka parë kur ka shkuar në spitalin e M. dhe ka shkuar me të njëjtit edhe në QKUK-Prishtinë ku kanë qëndruar disa ditë. Dëshmitari gjatë deklaramit të tij ka deklaruar se qëndron pranë deklaramit të tij të dhënë në polici me dt. 28.05.2008 në fq. 2 paragrafi i parë dhe i fundit, ku ndër të tjera ka thënë: “ pasi kemi kaluar shkallët e jashtme të palestrës, na ka dal përpara një djalë i ri me thikë në dorë, i cili fillimisht e ka sulmuar K. me atë thikë.....duke shtuar se qëndron edhe pranë deklaramit të dhënë në shqyrtimin gjyqësor në vitin 2019 dhe deklaramit të dhënë në shqyrtimin e fundit gjyqësor pra ka thënë se janë të vërteta. Tutje dëshmitari ka shtuar se në ato momente ka pësuar shok nga tronditja dhe nuk ka mundur të vërej se kush është rrezuar në atë konfrontim, mirëpo më vonë e ka kuptuar nga V. se ka pas edhe të rrëzuar V. i ka thënë se “e kam rrëzu dikën, mirëpo nuk e di kënd”. Në fund ka shtuar se në momentin kur kanë arritur policia, policët nuk i ka njoft.

Eksperti dr. Naim Haliti ekspert mjeko ligjor, pranë Institutit të Mjekësisë në Prishtinë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se, qëndron pranë mendimit të dhënë me dt. 23.10.2019, në gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe ka shtuar se duke u bazuar në dokumentacionin mjekësor paraprak të përshkruar në seancën gjyqësor të dt. 23.10.2019, në Mitrovicë si dhe këtë dokumentacion të fundit që i janë prezantuar gjatë shqyrtimit gjyqësor konkludon se lëndimet janë të lehta trupore për të dëmtuarin K. i Z.. Pra është qëndrimi i njëjtë që ka dhënë në seancën e kaluar edhe pse i është ofruar dokumentacioni shtesë. Sa i përket të dëmtuarit V. Z., po ashtu edhe tek V. Z. qëndron prapa mendimit të tij të cilën e ka dhënë në seancën e kaluar gjyqësore, edhe pse i është ofruar certifikata mjekësor e dt. 27.06.2008, të lëshuar nga Qendra Spitalore Sheik Zayud në Vushtri nga reparti i kirurgjisë të lëshuar nga dr. Isuf Zekaj kirurg, ku ka përshkruar se në bazë të fletë lëshimit të lëshuar nga QKUK në Prishtinë gjegjësisht nga reparti i kirurgjisë torokale,

plagët e shkaktuara kanë qenë nga mjeti i mbrehtë, në regjionin e barkut dhe të kraharorit, e që prek organet vitale-mushkëritë, dr. Isuf Zekaj, ka konsideruar si lëndim të rëndë trupor, andaj edhe vet eksperti konstaton se qëndron prapa mendimit të tij të dhënë në seancë gjyqësore në Mitrovicë, duke shtuar se është plotësuar mendimi i tij edhe me raportet tjera pasuese te cekura më lartë. Po ashtu ka shtuar se i dëmtuari V. Z. ka pësuar gjithsejtë 9 plagë prerëse shpuese dhe jo të gjitha kanë qenë të natyrës së rëndë, janë të përshkruara edhe në procesverbalin e seancës së kaluar. Nga ku rrjedh se dy plagë kanë pas thellësi rreth 1 cm, e të cilat janë të përshkruara me pasoja të prezencës së ajrit në hapësirën e majtë torakale, çka është përshkruar dhe në diagnozë, por vetëm prezenca e ajrit në hapësirat torakale quhet lëndim i rëndë trupor, sepse ka komunikuar plaga me hapësirën torakale, çdo lëndim i rëndë trupor mundet me qenë edhe vdekje prurës, por varësisht prej dëmtimeve përcjellëse mund të jetë i përhershëm apo i përkohshëm, ndërsa në këtë rast me pasoja të përkohshme. Në fund eksperti ka shtuar së bazuar në fletë lëshimin e spitalit nuk përshkruhet se kemi të bëjmë me shpim të mushkërive me mjet shpues, përveç prezencës së ajrit në hapësirën e majtë torakale, ku kirurgët ia kanë vendos një dren, e kanë klemu dhe shihet se në rent-genet plotësuese mushkëria e majtë është kthyer në vendin e vet dhe si e tillë është trajtuar me terapi adekuate, ku meqë pacienti është përmirësuar me gjendje të përgjithshme dhe lokale dhe i është rekomanduar për kontroll pas një javë. Kjo e plotëson atë që po thotë se lëndimi është i përkohshëm, dhe se këto nuk kanë qenë të rrezikshme për jetën, duke u bazuar në dëmtimet e përshkruara nga ana e kirurgëve, dhe në trajtimin e tyre, plagëve si dhe në thellësinë e mjetit që është fut.

I pandehuri Rr.Xh. në mbrojtjen e tij ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë në prokurori me dt. 27.06.2008, ndërsa mbrojtjen do ta jap në heshtje.

Prokurori i shtetit Ersan Qavolli, në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim fillimisht ka bërë përmirësimin e dispozitivit të aktakuzës, ka shtuar se provat me të cilat do të vërtetohet ajo gjendje faktike e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, janë deklarata e ekspertit dr. Naim Haliti dhënë në shqyrtim gjyqësor me datën 25.01.2024, Deklarata e S. S. dhënë në këtë shqyrtim gjyqësor me datën 27.11.2023, deklarata e të dëmtuarit/dëshmitarit K. Z. dhënë me datën 21.01.2019, deklarata e të dëmtuarit/dëshmitarit V. Z. dhënë me datën 21.01.2019, Deklarata e dëshmitarit S. B. e datës 18.07.2008, Deklarata e dëshmitarit R. B. e datës 18.07.2008, Raporti mjekësor në emër të të dëmtuarit K. Z. me nr. 17539 dt. 28.08.2008 lëshuar nga QKUK – Prishtinë, Certifikata mjekësore në emër të K. Z. dt. 27.06.2008, Certifikata mjekësore në emër të V. Z. dt. 27.06.2008, Fletë lëshimi me epikrizë në emër të K. Z. me nr. 3830/08 dt. 30.05.2008, Fletë lëshimi në emër të V. Z. nr. 3831/08 dt. 28.05.2008, Raporti i oficerit Nexhmi Miftari #2180 dt. 28.05.2008, Raporti i oficerit Bajram Sejdiu K.I. 6755 dt. 27.05.2008, Raporti i oficerit Selim Binaku KPS 8323 dt. 28.05.2008, Raporti i hetimeve, i hetueses Pranvera Deliaj #7219 dt. 28.05.2008, Raporti identifikues i forenzikës dt. 28.05.2008, Fotografitë e vendit të ngjarjes, thikës dhe të dëmtuarve, Përshkrimi i thikës së sekuestruar, Raporti informues i hetueses Pranvera Deliaj #7219 dt. 28.05.2008 20. Procesverbali mbi pajtimin dt. 03.07.2008, Raporti i aksidentit dt. 26.05.2008, me nr. 2008-CC-1146, Raporti policor i aksidentit për kundërvajtje me nr. 1403613 dt. 26.05.2008, Dokumentet e veturave të përfshira në aksident dhe Raporti i oficerit Shyqyri Mjeku #7024, si dhe ka cekur mbrojtjen e te pandehurit Rr. Xh. të dhënë me datën 25.01.2024 të cilën e ka zgjedhur të drejtën e tij të mbrohet në heshtje, gjë që i'a lejojnë të gjitha

dispozitat ligjore por që i pandehuri ka shtuar se qëndron prapa deklaratës së datës 27.06.2008 të dhënë në prokurori. Atë kohë i pandehuri e kishte pranuar se para ditës kritike ka shkaktuar një aksident trafiku. I pandehuri e pranon se ditën kritike e ka pas një thikë me vete. Po ashtu e pranon se atë ditë kishte lëvizur në të gjitha pikat e përmendura në dispozitiv dhe e pranon se me atë thikë i ka goditur të dëmtuarit por kinse sipas tij në vetëmbrojtje dhe vetëm duarve. Prokurori i shtetit ka shtuar se sa i përket kësaj, raportet mjekësore flasin të kundërtën, madje thuajse asnjë plagë nuk është duarve por të gjitha janë në pjesë të ndjeshme të trupit. I pandehuri ka deklaruar se kinse janë takuar rastësisht me të dëmtuarit. Ky version ndoshta do të ishte i “besueshëm” sikur i pandehuri të shkonte direkt në atë vend mirëpo në këtë rast, i pandehuri qysh në mëngjes kishte filluar lëvizjet e tij, fillimisht kishte shkuar tek R. Xh., pastaj tek lokali afër gjimnazit, pastaj tek kafja e gjahtarëve, pastaj ishte nis në drejtim të komunës, pastaj është kthyer kah ndërtesat e reja rrokaqielli, pastaj përball hallës së sporteve dhe aty kalon në anën e kundërt në trotuar tek halla e sporteve, pikërisht tek pjesa ku ishin të dëmtuarit! Ndoshta versioni i mbrojtjes në raport me kualifikimin do të ishte më i “besueshëm” sikur viktimat të kishin shkuar tek i pandehuri por këtu është e kundërta, i pandehuri gjatë gjithë paradites i kishte kërkuar viktimat. Versioni i tyre po ashtu do të mund të ishte më i “besueshëm” sikur lëndimet të ishin në pjesën e poshtme të trupit ose të duarve ose plagët të ishin vetëm prerëse por në rastin konkret lëndimet janë në pjesën e abdomenit, parakrah dhe të tjera madje janë edhe shpuese. Sa i përket natyrës së lëndimeve ato fare nuk kanë rëndësi për kualifikimin ligjor të kësaj veprë penale, kjo për faktin se me rëndësi për këtë veprë penale janë vendi i lëndimeve trupore të pësuar që në rastin konkret të gjitha lëndime janë pjesë të ndjeshme të trupit, mjeti me të cilin janë shkaktuar dhe mënyra si janë shkaktuar, që këtu lëndime janë shkaktuar me thikë dhe plagët janë shpuese dhe prerëse. Prandaj fakti se plagët janë shpuese e konfirmon qëllimin e tij për ta kryer këtë veprë penale. Në fund prokurori i shtetit ka theksuar se referuar te lartcekurave, pas administrimit të të gjitha këtyre provave dhe analizimit të tyre një nga një është shumë më shumë i bindur se ndaj të pandehurit do të merret aktgjykim dënues konform nenit 364 të KPPRK-së, për shkak se është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se në veprimet e tij qëndrojnë elementet e veprës penale të përshkruara si më lart. Me rastin e matjes së dënimit Gjykatës i propozon që si rrethana rënduese konform nenit 70 të KPRK-së të marrë për bazë shkallën e lart të dashjes nga ana e të pandehurit, mënyrën e kryerjes së veprës penale, dëmin e shkaktuar nga vepra penale, ndërsa së rrethana lehtësuese të merret për bazë fakti se palët janë pajtuar me njëra tjetrën.

Përf. i aut. i të dëmtuarit Luan Mehmetaj, në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se e përkrah fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, ndërsa lidhur me kërkesën pasurore juridike, i propozon gjykatës që të njëjtit ti udhëzojë në kontest të rregullt civil.

Mbrojtësi i të pandehurit av. M. H., në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ndër të tjera ka theksuar nuk është kontestuese se i pandehuri Rr. gjer dy dite para ngjarjes kritike pra me dt. 26.05.2008 me të dëmtuarit K. dhe V. Z. nuk është njohur, këtë ditë i pandehuri i cili merrej me shitjen e druve duke u kthyer me traktorin e tij në drejtim të qytetit, afër tregut ishte treguar i pakujdesshëm dhe kishte shkaktuar një aksident duke ia dëmtuar veturën të dëmtuarit K.. Sipas deklaramit të dëmtuarit K. ai kishte qenë i udhëzuar nga policia që pas dy ditësh rreth orës 10:00 të shkonte që të merrte procesverbalin e aksidentit në mënyrë që ta kompensonte dëmin. I dëmtuari ka vepruar ashtu dhe pas dy ditësh ka shkuar në stacionin policor dhe atje i kanë thënë

se duhet të priste sepse procesverbali ende nuk është gati pasi që në ato qaste nuk kishin përfunduar takimet zyrtare të oficerit i cili ishte i angazhuar për rastin e tyre e këtë gjë e ka vërtetuar edhe dëshmitari –kushëriri i dëmtuarit S. S. në deklaratën e tij. Pastaj ditën kritike i dëmtuari së bashku me nipin e tij V. janë takuar me kushëririn e tyre S. S. e të cilin e kanë lutur që të shkonte me ta në stacion për t’iu ndihmuar në komunikim pasi që të dëmtuarit një kohë të gjatë nuk jetonin në Kosovë dhe kishin problem me gjuhën shqipe. Për t’iu kaluar koha e pritjes të tre janë nisur në drejtim të palestrës sportive që Skënderi t’iu tregoi një zyre e cila iu kishte ndarë atij për aktivitete sportive. Aty kanë qëndruar 10- 15 minuta dhe pastaj së bashku kanë shkuar në Stacionin Policor. Sipas po këtij dëshmitari dhe te dëmtuarve K. dhe V. sapo kishin kaluar shkallët e palestrës dhe kishin dale në trotuar, kishin hasur në të pandehurin Rr. i cili i shoqëruar me dëshmitarin B. P., kishin filluar të sulmonin dhe atë i pandehuri Rr. me thikë ndërsa dëshmitari B. me grushte dhe me këtë rast të dëmtuarve iu është shkaktuar lëndime trupore. Mbrojtja shton se në këtë çështje me rëndësi është që në bazë të provave të vërtetojmë se në anën e cilit ishte motivi shkaktimin e këtij konflikti, pra sipas te dëmtuarve dhe dëshmitarit S. S. i pandehuri ka filluar sulm pa ndonjë paralajmërim në atë mënyrë që së pari ishte konfrontuar me të dëmtuarin K. e pastaj me të dëmtuarin V. këta nuk kishin dëgjuar ndonjë shprehje apo sharje nga i pandehuri dhe sulmi është ndërprerë pas intervenimit të policisë. Mbrojtësi ka shtuar se deklarata e të pandehurit ka qenë e kundërt me atë të dhënë nga të dëmtuarit pasi që i pandehuri ka deklaruar se ditën kritike rreth një orë para ngjarjes ishte takuar me shokun e tij këtu dëshmitarin B. P. me të cilin kishin ngrënë nga një tost e pastaj kishin vazhduar në drejtim të korzos së qytetit. Në afërsi të palestrës sportive i pandehuri ishte ndarë nga dëshmitari B. që të bënte një telefonate dhe në atë qaste kur ishte duke u përpjekur të vinte në kontakt përnjëherë ishte shfaqur i dëmtuari K. i cili i shoqëruar me dy persona, kishte filluar ofendimet kah ai dhe kishte filluar ta godiste, pas tij në sulm i ishte bashkangjitur edhe këtu i dëmtuari V. dhe personi tjetër të cilët kishin arritur disa herë ta godasin. I pandehuri në këto qaste me qëllim të mbrojtjes nga sulmi i tre personave kishte nxjerrë thikën dhe i dëmtuari K. ka pësuar lëndim si pasojë e goditjeve nga ana e të dëmtuarve gjersa ka intervenuar policia. Mbrojtja ka vazhduar me elabormin e deklarimit e deklaratës se të dëmtuarit tjetër V. i cili e ka pranuar se për shkak të mos njohjes se gjuhës shqipe dhe si e ka vërejtur konfrontimin në mes agjës së tij me të pandehurin ka ndërhyrë duke e goditur të pandehurin me grushte disa herë të cilin ka arit ta rrezoi për toke së paku 2-3 herë dhe se në ato çaste të pandehurit nuk ia ka parë armën e as që ka ndjerë ndonjë goditje gjerë në përfundimin e ngjarjes kur e ka parë se ka qenë i përgjakur. Ndërsa lidhur me deklarimin e dëshmitarit S. S. mbrojtja për dëshminë e tij ka shtuar se ai në dëshminë e tij përpiket qe ngjarjen ta paraqesë në atë mënyrë sikur të kishte ndodhur që i pandehuri Rr. papritmas me thikë në dorë i kishte sulmuar të dëmtuarit derisa ka arritur policia. Tutje mbrojtja ka përshkruar reagimin e të dëmtuarit K. gjatë shqyrtimit gjyqësor para Gjykatës Themelore në Mitrovicë e të cilin e përshkruan si një person nevrrik i cili në situatë të caktuar lehtë kalon në agresivitet, dhe për këtë konsideron që deklarata e tij të vlerësohet nga gjykata me kujdes, këtë fakt sipas mbrojtjes e vërteton edhe deklarata e ish policit S. B. e dhënë në zyrën e prokurorit të shtetit me dt. 18.07.2018 i cili në deklaratën e tij kishte thënë se sa ishte duke dalur nga stacioni i policisë kishte vërejtur te dëmtuarin K. duke polemizuar me policen Elheme Mehmeti për shkak të vonesës se raportit e që ndër të tjera ka dëgjuar K. duke u shprehur me fjalët “*se ju nuk dini të punoni, se me këtë rast do ta zgjedh vet se do të vras personin që me ka shkaktuar aksidentin*” dhe në këtë rast polici ka intervenuar duke e këshilluar dhe ja tërhequr vërejtjen të dëmtuarit për

sjelljet e tij, pas së cilave momente i dëmtuari gjatë largimit nga stacioni kishte përplasur derën me një agresivitet të theksuar. Po ashtu dëshmitari S. B. i cili ka qenë së bashku me policin R. B. ka shtuar se gjatë intervenimit të konfrontimit në mes të dëmtuarve dhe të pandehurit kanë parë se ishin duke e sulmuar tre persona të pandehurin dhe se vetëm pas urdhrit të tij ata e kanë ndërprerë sulmin, njeri nga ata është larguar nga vendi i ngjarjes (dëshmitari S. S.) dhe me tu afruar e ka parë të pandehurin Rr. të lënduar dhe pastaj të njëjtit i ka parë thikën të cilën e ka lëshuar pas urdhrit të tyre. Sipas mbrojtjes në prezencë të këtyre fakteve tek i pandehuri nuk kishte fare motiv e as që dinte se do të takonte të dëmtuarin K. ai takim ndodhi rastësisht, sulmi u provokua nga i dëmtuari K. të cilit iu bashkëngjiti i dëmtuari V. dhe dëshmitari S., kështu që në një situatë të tillë i pandehuri u gjet në gjendje të mbrojtjes nga sulmi i atëçastshëm pra i pandehuri ka vepruar për të mënjeluar sulmin e kundërligjshëm të dëmtuarve ndaj tij. Tek i pandehuri nuk ka pasur asnjë motiv, përkundrazi ka shpreh keqardhje e ka ndier veten fajtor për aksidentin e ndodhur për dëmtimin e veturës së të dëmtuarit K.. Pra sulmin nuk e ka provokuar i pandehuri pasoi papritmas nga i dëmtuari K. e të cilit iu kanë bashkëngjitur edhe i dëmtuari V. dhe dëshmitari S. S.. Se i pandehuri ishte mbrojtur nga një sulm tejet i furishëm dhe i ashpër nga ana e të dëmtuarve dhe dëshmitarit mbrojtja e vërteton këtë fakt nga natyra e plagëve gërvishtëse përkatësisht sipërfaqësore me përjashtimin e një lëndimi të shkaktuar të dëmtuarit V. e që ishte rezultat i shpejtësisë së zhvillimit të ngjarjes dhe sulmit të pandërprerë nga ana e të dëmtuarve e në veçanti të dëmtuarit V. i cili ishte tejet i fuqishëm dhe shumë dominues në sulm. Andaj bazuar në të lartcekurat mbrojtja propozon që i pandehuri të lirohet nga akuza pasi që sipas mbrojtjes i pandehuri ka vepruar në mbrojtje të nevojshme, në rastin e pavolitshëm mund të inkorporohet në suazat e tejkalimit të mbrojtjes së nevojshme për lëndimet e shkaktuara. Megjithatë, sipas mbrojtjes veprimet e të pandehurit duhen të cilësohen në raport me të dëmtuarin K. Z. në veper penale lëndim i lehtë trupor ndërsa për të dëmtuarin V. Z. në vepër penale lëndim i rëndë trupor për të cilat ka parashkrim absolut të ndjekjes penale andaj mbi këto arsye konsideron se i pandehuri duhet të lirohet nga akuza. Në fund mbrojtja ka kërkuar nga trupi gjykues që të këtë parasysh faktin se i mbrojturi i tij nuk ka pasur asnjë kundërvajtje dhe asnjëherë nga kjo ngjarje e deri me tani nuk ka ra ndesh me ligjin, është familjar, i gjendjes jo të mirë ekonomike pasi që jeton nga bujqësia dhe blegtoria dhe se dënimi për të nuk paraqet kurrfarë efekti, sepse këtë e ka dëshmuar për më shumë se 15 vite me sjellje të shkëlqyeshme si qytetar i regjionit të Mitrovicës.

I pandehuri Rr.Xh., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e mbrojtësit të tij dhe nuk ka tjetër çka të shtojë.

Gjendja faktike e vërtetuar nga Gjykata

Gjykata pas administrimit të provave, i ka vlerësuar të njëjtat veç e veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjykata këtë gjendje faktike vërtetoi nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri, është vrasje e mbetur në tentativë nga neni 147 par. 1 nënpar 1.11 lidhur me nenin 20 të KPPK-së. Në paragrafin, 1 te nenit 147 është paraparë “Me së paku dhjetë vjet burgim apo me burgim afatgjatë dënohet personi i cili” ndërsa në piken

1.11 të këtij paragrafi është paraparë që “Me dashje kryen dy apo më shumë vrasje, përveç veprave të cilat janë paraparë në nenet 148 dhe 150 të këtij Kodi ose”,

Në nenin 20 të KPPK-së, është paraparë që “Kushdo që me dashje ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale dhe vepra nuk është kryer ose elementet e veprës së qëllimshme penale nuk janë realizuar, ai konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale.”, e që në rastin konkret kemi të bëjmë me vrasje e mbetur në tentativë nga neni 147 par. 1 nen par. 1.11 lidhur me nenin 20 të KPPK-së.

Gjykata gjeti se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, ngase nga veprimet e të pandehurit shihet qartë se i njëjti me dashje ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjeti se ditën kritike përderisa të dëmtuarit K. dhe V. Z., kanë qenë së bashku edhe me dëshmitarin S. S., afër urës kryesore mbi lumin I., përballë palestrës sportivei në Mitrovicë, i pandehuri ju del para dhe pa asnjë paralajmërim fillimisht e godet me thikë, 5 herë të dëmtuarin K. Z. në regjionin e krahorit, afër zemrës, bark, shpindë dhe në dorën e majtë, me çka i shkakton plagë në pjesën e abdomenit dhe të toraksit me një mjet prerës-shpues, e më pas pasi që i dëmtuari V. Z., ndërhyr për ti ndarë, i njëjti goditet 9 herë me thikë nga i pandehuri Rr.Xh..

Gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, Gjykata e vërtetoi nga provat materiale dhe personale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Gjykata ju fali besimin deklaratës së të dëmtuarit K. Z., shqyrtimin gjyqësor të dt. 21.01.2019, ku kishte deklaruar se, dy ditë para ngjarjes kritike e kanë pas një aksident të komunikacionit me të pandehurin Rr.Xh., poashtu gjykata i fali besimin deklaratës së të dëmtuarit K. Z., i cili ndër të tjera deklaroi se, me datën 28.05.2008 me nipin dhe me kushëririn S. S. e kanë lënë automjetin te palestra e sporteve dhe janë nisur në Stacionin e Policisë, me qëllim që ta marrin procesverbalin për shkak të aksidentit të komunikacionit dhe kur kanë ardhur afër urës, ky dhe S. kanë qenë duke ecur përpara, kurse nipi i tij V. ka qenë pas tyre, nuk e dinë sa ka qenë distanca në mes tyre dhe të pandehurit, me sa i kujtohet i pandehuri ka pasur thikën në dorë. I dëmtuari K. Z. e ka përshëndetur të pandehurin dhe në atë moment i pandehuri është drejtuar nga i dëmtuari K. dhe i dëmtuari K. e ka pa se nuk është ndonjë lojë dhe i pandehuri Rr. e ka goditur, e ka therë me thikë. Ndërsa kushëririn S. S., ka thënë se “ne jemi shqiptar”, pasi që këta kanë qenë duke folur në gjuhën kroate, andaj gjykata nga deklaratat e të dëmtuarit vërtetoi faktin se i pandehuri Rr.Xh. e ka sulmuar me thikë këtu të dëmtuarin K. Z. në mënyrën siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi,

Deklarata e të dëmtuarit K. Z. ka përputhje edhe me deklaratën e të dëmtuarit V. Z., i cili në shqyrtimin gjyqësor të dt. 21.01.2019 ka deklaruar se “ se me datën 25.05.2008, së bashku me axhën e tij kanë shkuar në stacionin policor për me i marr disa raporte, te stacioni policor, për afërsisht afër urës janë sulmuar nga dy persona dhe ka filluar rrahja, e kanë sulmuar axhën e tij K.. I dëmtuari V. ka qenë pas axhës së tij, diku 2 apo 3 metra, atëherë V. ka ndërhyr për të mbrojtur axhën e tij dhe që ta pengojë rrahjen. Pasi që ka ndërhyrë për ta penguar rrahjen, i njëjti i ka pësuar 5 apo 6 goditje dhe ky ia ka kthyer goditjet. I dëmtuari V. ka deklaruar se i pandehuri

Rr. e ka goditur në trup, mirëpo i dëmtuari nuk e ka ditur se është goditur me thikë, por ka menduar se është goditur me grushta. I dëmtuari V. ka shtuar se nuk ka vërejtur gjak në trupin e tij dhe as në trupin e të dëmtuarit K., deri në momentin kur kanë ardh policia.

Gjykata ja fali besimin dëshmisë se Dëshmitarit S. S. te dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor me dt. 27.11.2023, ku deklaroi se; ditën kritike, është takuar me kusheririn e tij K. Z., sepse K. kishte pas një aksident më herët, kanë shkuar tek ura e I. në Mitrovicë. K. ishte më herët në polici për arsye me marr procesin e aksidentit, pasi që K. ka dal nga policia, janë takuar tek palestra e sporteve, përafërsisht 200 apo 300 metra larg stacionit policor. Aty është takuar me K. dhe nipin e K., V. S.. Kanë qëndruar 5 deri 10 minuta brenda në palestrën e sporteve në Mitrovicë. Kur kanë dal nga palestra e sporteve, dëshmitari S. ka qenë duke folur në gjuhën kroate me V.. Atëherë janë sulmuar, mirëpo dëshmitari fillimisht ka menduar se arsye pse janë sulmuar, kanë qenë sepse kanë qenë duke folur në gjuhën serbokroate dhe dëshmitari ka bërë titur se “jemi shqiptar”. Dëshmitari ka cekur se nuk e kanë pritur këtë sulm dhe nuk e din sa persona kanë qenë. Nuk ka mundur ti ndajë dhe nuk ka mundur të ndërhyjë, ka shtuar se personalisht nuk e ka goditur askush, mirëpo ka pësuar një gërvishtje duke u mundur që ti ndajë. Po ashtu dëshmitari ka cek se të sulmuar ka qenë V. dhe K.. Andaj gjykata nga dëshmia e dy të dëmtuarve dhe dëshmitarit S. S., i cili ishte dëshmitar okular, vërtetoi faktin se i pandehuri Rr. Xh. i ka sulmuar dy të dëmtuarit, duke i goditur me thikë siç është cekur në dispozitiv të aktgjykimit. Pra dëshmitë e dy të dëmtuarve dhe dëshmitarit S., kanë qenë në përputhje sa i përket mënyrës se si e përshkruajnë sulmin që ka ardh nga i pandehuri Rr.Xh..

Gjykata vlerëson se edhe pse në rastin konkret i dëmtuari K. Z. ka pësuar lëndime të lehta trupore, ndërsa i dëmtuari V. Z. ka pësuar lëndime të rënda trupore, Gjykata vlerëson se natyra e lëndimeve trupore nuk është element përcaktues i kualifikimit të kësaj veprë penale, sepse qenësore për kualifikimin e veprës penale në këtë rast është vendi i shkakimit të plagëve, mënyra e shkakimit, mjeti me të cilin janë shkakuar këto plagë dhe dashja e të pandehurit për kryerjen e veprës penale e që në rastin konkret gjykata ka vlerësuar se dashja e të pandehuri ka qenë privimi nga jeta e të dëmtuarve.

Duke pas parasysh se i dëmtuari K. Z. është goditur 5 herë me thikë nga i pandehuri Rr.Xh., e të cilat plagë i ka përshkruar në mënyrë të hollësishme eksperti në shqyrtimin gjyqësor, si dhe i dëmtuari V. Z., ka pësuar 9 plagë prerëse-shpuese dhe për pasojë ka ardhur deri te prezenca e ajrit në hapësirën e majtë torakale dhe si i tillë kualifikohet si lëndim i rëndë trupor, Gjykata gjeti se qëllimi i të pandehurit ka qenë privimi nga jeta i të dëmtuarve K. dhe V. Z., mirëpo duke pasë parasysh rezistencën e të dëmtuarve e posaçërisht rezistencën e të dëmtuari V., i pandehuri nuk ka arritur ta realizoj vrasjen, dhe në asnjë moment i pandehuri nuk e ka ndal sulmin ndaj te dëmtuar me vullnetin e tij, por të dëmtuari kanë rezistuar deri ne momenti qe në vendngjarje kanë arritur zyrtaret Policor, dëshmitarët R.B. dhe S. B..

Gjykata ka vlerësuar edhe deklaratën e dëshmitarit R. B., të dhënë në procedurën paraprake, me dt. 18.07.2008, e cila deklaratë është lexuar në shqyrtimin gjyqësor të dt. 25.01.2024, e ku dëshmitari R., ndër të tjera kishte deklaruar se, ditën kritike me dt. 28.05.2008, ka qenë në detyrë në vendin te Ura kryesore mbi lumin I., e atë prej orës 10:00, deri në orën 12:00, së bashku me

kolegun e tij S. B.. Diku rreth orës 11:00, saktësisht në orën 10:55min, përmes radio lidhjeve ka dëgjuar kërkesën nga rreshterat për asistim në një përlëshje që ka ndodhur në afërsi të palestrës sportive, e njëkohësisht ka dëgjuar edhe zhurmën meqenëse ishin shumë afër. Dëshmitari R.B. së bashku me kolegun e tij S. B. janë nisur në drejtim të vendit të ngjarjes dhe kur janë afruar ka vërejtur se në qoshe ishin duke u rrahur, B. P. dhe K. Bistrica (emri K. B., gjykata vlerëson se dëshmitari iu ka referuar K. Z., meqenëse në këtë rast në asnjë provë apo në ndonjë shënim nuk është përmendur ndonjë person me emrin K. B.), për emra të të cilëve ka mësuar më vonë, kurse më poshtë ishin edhe duke u përlëshur edhe tre persona tjerë, në mesin e tyre Rr.Xh. dhe V. Z., kurse personi i tretë ka ikur derisa këta kanë bërë sigurimin. Dëshmitari R. B., poashtu ka deklaruar se në këtë rast e ka vërejtur Rr. se vinte në drejtim të K. me një brisk në dorë dhe ishte i përgjakur dhe i ajur në fytyrë. I pandehuri Rr.Xh. i është nënshtruar urdhërave të policisë, ka ra në gjunjë dhe e ka lëshuar thikën, thika ka qenë diku 7 apo 8 cm tehu i saj. Pas kësaj me ndihmën e kolegëve të tjerë që kanë ardhur, i kanë prangosur Rr. dhe B., për të dëmtuarit nuk e din se a janë prangosur a jo. Poashtu dëshmitari ka shtuar se sa i kujtohet K. ka qenë i plagosur në krah, ndërsa V. nuk ka mundur ta vërejë saktë se ku ka qenë i lënduar. Mirëpo në vendin e ngjarjes i ka vërejtur disa pika të gjakut në trotuar.

Gjykata ka vlerësuar edhe deklaratën e dëshmitarit S. B., të dhënë në procedurën paraprake, me dt. 18.07.2008, e cila deklaratë është lexuar në shqyrtimin gjyqësor të dt. 25.01.2024, e ku dëshmitari S., ndër të tjera kishte deklaruar se së bashku me kolegun R. B. kanë shkuar në vendin ku kanë qenë të caktuar në urën kryesore që gjendet afër hallës së sporteve dhe derisa ishin aty, diku rreth orës 11:00, saktësisht 10:55, përmes radio lidhjeve kanë dëgjuar kërkesën nga rreshterat për një asistim në një përlëshje që ka ndodhur në afërsi të palestrës sportive. Meqenëse ishin shumë afër, dëshmitari S. së bashku me kolegun e tij R. janë nisur në drejtim të vendit të ngjarjes dhe kur janë afruar kanë vërejtur që tre persona e sulmonin një person, me tu afruar më afër e ka vërejtur se i sulmuar ka qenë Rr.Xh. dhe atë nga K. Z., të cilin e ka njohur menjëherë pasi që më herët e kishte parë në stacion dhe së bashku me të kanë qenë edhe dy persona tjerë, njëri prej të cilëve ka ikur, kurse tjetri ishte V. Z.. Dëshmitari S.-zyrtar policor iu është drejtuar me urdhër verbal që të shpërndahen, të njëjtit kanë vepruar sipas urdhrit dhe janë shpërndarë e ku me këtë rast dëshmitari S. B. e ka vërejtur të pandehurin Rr.Xh. i cili ishte i përgjakur në fytyrë, ndërsa në dorë e ka vërejtur se mbante një brisk. Dëshmitari S. ka shtuar se nuk e ka parë momentin se i pandehuri Rr.Xh. e ka goditur dikënd me brisk. Nuk e ka parë fare se V. dhe K. kanë qenë të lënduar, këtë e ka marr vesh më vonë nga kolegët të cilët kanë raportuar nga Shtëpia e Shëndetit. Poashtu ka shtuar se të dëmtuarve V. dhe K. Z., nuk ju ka parë ndonjë mjetë në dorë. Në vendin e ngjarjes ka parë disa pika të gjakut, mirëpo në atë kohë ka menduar se janë duke rrjedhur nga fytyra e të pandehurit Rr. pasi që i njëjti ka qenë i lënduar në fytyrë.

Gjykata nga dëshmia e dëshmitarëve R. B. dhe S. B., vërteton faktin se ditën kritike kur kanë shkuar në vendin e ngjarjes, i pandehuri Rr.Xh., në dorë ka qenë duke e mbajtur thikën, pasi që dëshmitarët R. dhe S. kanë deklaruar se të pandehurit ia kanë parë në dorë thikën. Edhe pse dëshmitarët R. B. dhe S. B. nuk e kanë parë të pandehurin Rr. Xh., duke i goditur me thikë të dëmtuarit, gjykata vlerëson se fakti se të dëmtuarit K. dhe V. Z. janë goditur me thike nga i pandehuri Rr., ditën kritike, vërtetohet nga raportet mjekësore dhe nga dëshmia e dëshmitarit, ekspertit mjeko ligjor dr. Naim Haliti, i cili në shqyrtimin gjyqësor të dt. 25.01.2024, ka deklaruar

se “qëndron pranë mendimit të dhënë me dt. 23.10.2019, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe ka shtuar se duke u bazuar në dokumentacionin mjekësor paraprak të përshkruar në seancën gjyqësore të dt. 23.10.2019, në Mitrovicë si dhe këtë dokumentacion të fundit që i janë prezantuar gjatë shqyrtimit gjyqësor konkludon se lëndimet janë të lehta trupore për të dëmtuarin K. Z.. Pra është qëndrimi i njëjtë që ka dhënë në seancën e kaluar edhe pse i është ofruar dokumentacioni shtesë. Sa i përket të dëmtuarit V. Z., po ashtu edhe tek V. Z. qëndron prapa mendimit të tij të cilën e ka dhënë në seancën e kaluar gjyqësore, edhe pse i është ofruar certifikata mjekësore e dt. 27.06.2008, të lëshuar nga Qendra Spitalore Sheik Zayud në Vushtri nga reparti i kirurgjisë të lëshuar nga dr. Isuf Zekaj kirurg, ku ka përshkruar se në bazë të fletë lëshimit të lëshuar nga QKUK në Prishtinë gjegjësisht nga reparti i kirurgjisë torokale, plagët e shkaktuara kanë qenë nga mjeti i mbrehtë, në regjionin e barkut dhe të kraharorit, e që prek organet vitale-mushkëritë, dr. Isuf Zekaj, ka konsideruar si lëndim të rëndë trupor, andaj edhe vet eksperti konstaton se qëndron prapa mendimit të tij të dhënë në seancë gjyqësore në Mitrovicë, duke shtuar se është plotësuar mendimi i tij edhe me raportet tjera pasuese te cekura më lartë. Po ashtu ka shtuar se i dëmtuari V. Z. ka pësuar gjithsejtë 9 plagë prerëse shpuese dhe jo të gjitha kanë qenë të natyrës së rëndë, janë të përshkuara edhe në procesverbalin e seancës së kaluar. Nga ku rrjedh se dy plagë kanë pas thellësi rreth 1 cm, e të cilat janë të përshkuara me pasoja të prezencës së ajrit në hapësirën e majtë torakale, çka është përshkruar dhe në diagnozë, por vetëm prezenca e ajrit në hapësirat torakale quhet lëndim i rëndë trupor, sepse ka komunikuar plaga me hapësirën torakale, çdo lëndim i rëndë trupor mundet me qenë edhe vdekje prurës, por varësisht prej dëmtimeve përcjellëse mund të jetë i përhershëm apo i përkohshëm, ndërsa në këtë rast me pasoja të përkohshme. Në fund eksperti ka shtuar së bazuar në fletë lëshimin e spitalit nuk përshkruhet se kemi të bëjmë me shpim të mushkërive me mjet shpues, përveç prezencës së ajrit në hapësirën e majtë torakale, ku kirurgët ia kanë vendos një dren, e kanë klemu dhe shihet se në rent-genet plotësuese mushkëria e majtë është kthyer në vendin e vet dhe si e tillë është trajtuar me terapi adekuate, ku meqë pacienti është përmirësuar me gjendje të përgjithshme dhe lokale dhe i është rekomanduar për kontroll pas një javë. Kjo e plotëson atë që po thotë se lëndimi është i përkohshëm, dhe se këto nuk kanë qenë të rrezikshme për jetën, duke u bazuar në dëmtimet e përshkuara nga ana e kirurgëve, dhe në trajtimin e tyre, plagëve si dhe në thellësinë e mjetit që është fut.

Dëshmitari, S. B. në deklaratën e dhënë në Prokurori me datën 18.07.2008, ka deklaruar se “ unë nuk e kam parë momentin se i pandehuri Rr.Xh. e ka goditur viktimën me brisk, nuk kam parë fare se V. dhe K. kanë qenë të lënduar, këtë e kam marrë vesh më vonë nga kolegët të cilët kanë raportuar nga shtëpia e shëndetit”. Dëshmitari po ashtu ka deklaruar “se bashku me kolegun R. jemi nisur në drejtim të vendit të ngjarjes se kur jemi afruar unë e kam vërejtur se të tre persona e sulmonin një person, më tu afruar më afër kam vërejtur se ishte sulmuar ka qenë Rr.Xh. dhe atë nga K. Z.”. Edhe pse dëshmitari S. B. ka deklaruar se nuk e ka parë te pandehuri duke i sulmuar te dëmtuarit por i ka parë tre persona duke sulmuar të pandehurin, për gjykatën kjo deklaratë vërteton faktin se të dëmtuarit janë goditur me thike nga ana e të pandehurit, para se zyrtaret policor te arrinin ne vendin e ngjarjes, pasi qe fakti se të dëmtuari kanë qenë te goditur me thikë vërtetohet nga raportet mjekësore.

Gjykata vlerësoi edhe deklaratën e të pandehurit Rr.Xh., dhënë në procedurën paraprake me dt. 27.06.2008, pasi që i pandehuri në shqyrtimin gjyqësor të dt. 25.01.2024, deklaroi se mbetet pranë deklaratës së dhënë në Prokurori me dt. 27.06.2008, ndërsa në këtë shqyrtim gjyqësor do të mbrohet në heshtje. Përveç faktit që i pandehuri ka përshkruar itinerarin se si ka vepruar gjatë ditës kritike, dhe ka treguar faktin se përballë hallës së sporteve ka kaluar në anën e kundërt të trotuarit pikërisht te pjesa ku ishin të dëmtuarit, gjykata nuk ja fali besimin deklaratës së të pandehurit kur i njëjti ka deklaruar se derisa ka qenë duke e thirr D. në telefon e ka dëgjuar një bërtim “ku je o hajvan, o kali që e qon kryt si qen përpjetë, kemi me të bo lloj se nuk po e merr parasysh dëmin që na e ke shkaktuar” dhe i pandehuri kinse iu është përgjigjur se kjo ka qenë një rastësi dhe është në gjendje ta paguajë dëmin dhe me këtë punë merret shteti. Gjatë kësaj bisede është sulmuar me boks në qafë nga tre personat meqë rast ka humbur vetëdijen dhe derisa e kanë goditur ju ka tërhequr vërejtjen që të largohen pasi që i pandehuri Rr. e ka nxjerr briskun duke iu thënë “ju qoj poshtë”, mirëpo të dëmtuarit përsëri e kanë sulmuar dhe e din se në një moment e ka humbur vetëdijen. I pandehuri e ka mohuar veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë duke pretenduar se nuk ka ekzistuar dashja e të njëjtit për ta kryer këtë vepër duke u arsyetuar se të dëmtuarit kanë qenë te paret se e kanë sulmuar, ndërsa i pandehuri ka vepruar në vetëmbrojtje, mirëpo gjykata deklaratës së të pandehurit Rr. nuk ja fali besimin pasi që deklarata e tij ishte në kundërshtim me deklaratat e të dëmtuarve si dhe me provat tjera sidomos në kundërshtim me raportet mjekësore dhe dëshminë e ekspertit mjeko ligjor dr. Naim Haliti ku përshkruhet vendi dhe natyra e lëndimeve trupore.

Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor ka administruar edhe provat materiale dhe atë raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes raporti identifikues i forenzikës i dt. 28.05.2008, me të cilin vërtetohet fakti se ngjarja ka ndodhur në rrugën “.... afër urës mbi lumin “...r” përballë hallës së sporteve “..... “ndërsa nga foto dokumentacioni shihet pamja e përgjithshme e vendit të ngjarjes, njolla të gjakut, si dhe thika e cila është përdorur nga ana e të pandehurit.

Nga fletë lëshimi me epikrizë lëshuar nga QKUK në Prishtinë – Klinika e Kirurgjisë Kirurgjia Abdominale “B” 3830/08, vërtetohen lëndimet trupore që i ka pësuar i dëmtuari K., ku përshkruhet se i dëmtuari K. ka marrë plagë në regjionin e barkut dhe të kraharorit nga mjeti i mprehte.

Nga fletë lëshimi lëshuar QKUK në Prishtinë-Klinika Kirurgjisë-Kirurgjia torokale me numër amëz 3831/08, në emër të V. Z., është vërtetuar se i dëmtuari V. Z. ka pësuar plagë shpuese – prerëse të shkaktuara nga mjeti i mbrehtë dhe pneumotoraksit traumatic të shkaktuar në këtë rast ku i dëmtuari sipas raportit ka ndier dhimbje të plagëve dhe kraharorit në anën e majtë.

Nga certifikata mjekësore e lëshuar nga Qendra spitalore “Sheikh Zayed”-reparti i kirurgjisë në Vushtri në emër të K. e V. Z., të dt. 27.06.2008, vërtetohet se i dëmtuari Vedran ka pësuar lëndime të natyrës së rëndë trupore ndërsa K. i Z. lëndime të natyrës së lehtë trupore.

Nga vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve është vërtetuar se me dt. 28.05.2008 nga i pandehuri është konfiskuar thika patentë e dorëz ngjyre të bardhë.

Pra nga të gjeturat me lartë gjykata vërtetoi faktin se në veprimet e të pandehurit Rr.Xh., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, vrasje e rënd e mbetur ne tentativë nga neni 147 par. 1 nën par. 1. 11 e lidhur me nenin 20 të KPPK-së. Pasi që i pandehuri duke vepruar me dashje ka goditur me thikë te dëmtuarit K. dhe V. Z., në kohen, vendin dhe mënyrën e përshkruar si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk u vërtetuan pretendimet e te pandehurit se kinse veprimet i ka ndërmarrë ne vetëmbrojtje, pasi që nuk kishte asnjë provë qe vërteton faktin se të dëmtuarit e kanë sulmuar fillimisht te pandehurin.

Gjykata gjeti se motivi që e ka shtyrë të pandehurin për ta kryer veprën penale ka ardhë si rrjedhojë e një aksidentit te komunikacionit të ndodhur dy ditë me herët e ku i pandehuri me traktorin e tije kishte goditur nga pas veturën e të dëmtuarit K. Z., dhe me këtë rast të njëjtit kishin pas një fjalosje në mes tyre si rrjedhojë e këtij aksidenti.

Sa i përket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshtëm për veprën e kryer dhe atë e ka kryer me dashje. Ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të te pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 64 të KPRK-së. Rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata mori faktin se është hera e parë që i pandehuri bie ndesh me ligjin, gjendjen e dobët ekonomike, faktin se me palën e dëmtuar janë pajtuar, ndërsa rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallen e lartë të dashjes për kryerjen e veprës penale pasi qe i pandehuri te dëmtuarin K. e ka goditur 5 herë me thikë , ndërsa te dëmtuarin V. Z. e ka goditur 9 herë .

Gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të pandehurin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë, siç është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit, e që është pengimi i të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahet nga kryerja e veprave penale, konform nenit 34 të KPRK-së.

Të pandehurit në dënimin e shqiptuar me burgim, do ti llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim nga dt.28.05.2008 e deri me dt.21.07.2008.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.1 dhe 2.6 të KPP-se, Gjykata ka përcaktuar për të pandehurit shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 200 (dyqind)euro, dhe shpenzimet për paushallin gjyqësor në shumë prej 100 (njëqind) euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj.

Konform nenit 36 par.1, 2, 3, nënpar.3.2, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, të pandehurit i obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konform nenit 462 par 2, të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarit i udhëzoi në kontest civil.

Konform nenit 60 par.1 të KPPK-së, te pandehurit i konfiskohet një thikë.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, Gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË,-Departamenti Për Krime të Rënda
PKR.nr.33/23 më datë 04.03.2024**

**Bashkëpunëtore profesionale
Selvane Bukleta**

**Kryetari i Trupit Gjykses
Shaqë Curri**

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykatë.